



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. 12414 Prot

Shkodër, më 03.09.2020

**UDHËZIM**

Nr. 5 datë 03/09/2020

**“ PËR MENAXHIMIN E SITUATËS NË INSTITUCIONIN BASHKIA SHKODËR,  
GJATË PANDEMISË COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 8, të nenit 9 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; pika 1, neni 133 i ligjit nr.7961 datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit 152/2103 “Për nëpunësin civil”; Ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.223, datë 1.4.2020 Për një ndryshim në urdhrin nr. 156, datë 10.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin me përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”; Rregullore e Bashkisë Shkodër; Udhëzues i OBSH-së për punëdhënësit në lidhje me menaxhimin e vendit të punës gjatë COVID-19; Urdhër nr.38.prot, datë 12.05.2020 “Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19” i Departamentit të Administratës Publike; Urdhëresë e Titullarit të Bashkisë Shkodër Nr.8364, datë 17.06.2020; Shkresa me nr.3809/1, datë 26.08.2020 e Departamentit të Administratës Publike administruar me nr.11792/1.prot, datë 28.08.2020,

**Udhëzoj :**

**I. Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim për të siguruar:

1. Mbrojtjen e shëndetit të punonjësve të administratës së Bashkisë Shkodër;
2. Mbarëvajtjen e punës në ambiente të shëndetshme;
3. Vijimësinë normale në ushtrimin e kompetencave dhe në kryerjen e detyrave funksionale në institucion;
4. Kufizimin dhe parandalimin e transmetimit të infeksionit COVID-19;
5. Përcaktimin e masave për kufizimet dhe rregullat sipas praktikave të duhura të higjenes për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

## **II. Masat për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së COVID-19 në institucion.**

1. Për t'u mbrojtur nga infeksionet, gjatë gjithë orarit të punës të gjithë punonjësit kanë përgjegjësinë për t'u kujdesur për shëndetin dhe sigurinë e tyre dhe të tjerëve duke zbatuar masat parandaluese dhe kontrolluese. Kjo përfshin adoptimin e sjelljeve të sigurta në punë, përdorimin e saktë të pajisjeve të sigurisë dhe pajisjeve mbrojtëse si përdorimi i maskave dhe dorezave, garantimin e praktikave të mira higjienike, siç është larja e shpeshtë e duarve ose aplikimi i dezinfektantëve me përbërje alkooli të paktën 60%.

2. Të sigurohet distancimi social dhe përshtatja e tavolinave të punës duke siguruar distancën prej 1.5-2 m. Duhet të respektohen praktikat e etikës respiratore si dhe rekomadohet që të mos përdoret shtrëngimi i duarve dhe përqaqimet midis punonjësve dhe të zbatohet përdorimin e metodave të tjera jokontaktuese të përshëndetjes.

3. Sportelet e shërbimeve të pritjeve, për të cilat nevojitet kontakti i drejtpërdrejtë me qytetarët duhet të marrin masa për të shfrytëzuar në maksimum shërbimet online në mënyrë që të kufizohen kontaktet dhe të shmanget grumbullimi i publikut në sportele.

## **III. Detyrimet e nëpunësve dhe punonjësve të administratës.**

1. Në rast se një punonjës shfaq simptoma të ngjashme me ato të virusit ose ka qenë "në kontakt të ngushtë" me dikë që ka ose mund të ketë COVID-19, si në rastet me poshtë:

- Kontakti ballë për ballë më shumë se 15 minuta me një person, i cili ka rezultuar pozitiv me COVID-19 në periudhën që shtrihet nga 24 orë para fillimit të shfaqjes së simptomave tek ai person;

- Ndarja e një hapësire të mbyllur me një person i cili ka rezultuar pozitiv me COVID-19 për një periudhë të zgjatur (p.sh. më shumë se 2 orë) në periudhën që shtrihet nga 24 orë para fillimit të shfaqjes së simptomave në rastin e konfirmuar;

- Bashkëjetesa në të njëjtën shtëpi ose ambient të përbashkët me një person të infektuar;

punonjësi është i detyruar të njoftojë menjëherë eprorin direkt, dhe të kërkojë kujdes urgjent shëndetësor në strukturat përkatëse të shëndetësisë.

2. Eprorët janë të detyruar të lajmërojnë menjëherë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në rast mungese të punonjësve në varësi të tyre, për shkaqet që lidhen më pandeminë.

3. Punonjësit të cilët janë të dyshuar apo të konfirmuar me COVID-19, duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse një dokument të lëshuar nga strukturat përkatëse shëndetësore për periudhën e mosprezencës së tyre.

4. Në qoftë se gjendja shëndetësore e tyre nuk krijon probleme dhe pamundësi për kryerjen e detyrave, punonjësit mund të realizojnë detyrat funksionale online duke propozuar një plan pune i cili duhet të jetë i miratuar nga eprori direkt dhe i pasqyruar në listë prezencën që dorëzohet në fund të muajit.

5. Në rast pamundësie të dorëzimit të dokumentacionit apo të kryerjes së punës online, punonjësit janë të lirë të ezaurojnë lejen e tyre të zakonshme të pakonsumuar.

6. Sa më sipër, sipas rastit përkatës, do të pasqyrohen në listë-prezenca nga eprorët (raportë; punë online; leje e zakonshme).

6. Kur një punonjës ka qënë i karantinuar apo vetë-karantinuar si në rastet e lartpërmendura dhe ka përfunduar këtë periudhë, me paraqitjen në detyrë ai duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse dokumentin e lëshuar nga strukturat përkatëse ku vërtetohet gjendja shëndetësore e tij, kjo për efekt të sigurisë shëndetësore në punë.

Zbatimi me korrektësi dhe përpikmëri i këtij udhëzimi është detyrim dhe përgjegjësi e të gjithë punonjësve të Bashkisë Shkodër.



**KRYETAR**

**Vollana ADEMI**